

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 587 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

VENDIM Nr. 52, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi Relacion mbi punimet në kuadër të projektit "*Rehabilitimi Manastirit të Shën Mërisë dhe Pejsazhit të Parkut Arkeologjik të Apolonisë, Fier , Shqipëri*", paraqitur nga ZAKPA Apoloni, shoqëria "AD STAR" sh.p.k. dhe ASHA

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin mbi punimet në kuadër të projektit "*Rehabilitimi Manastirit të Shën Mërisë dhe Pejsazhit të Parkut Arkeologjik të Apolonisë, Fier , Shqipëri*", paraqitur nga ZAKPA Apoloni, shoqëria "AD STAR" sh.p.k. dhe ASHA.
2. Pas gërmimit të shpëtimit të realizuar nga shoqëria "AD STAR" sh.p.k në zonën e parashikuar për Depon e ujit Nr. 2, të vijojnë punimet për zbatimin e kësaj depoje.
3. Gjetjet e përfituara nga ky gërmim të depozitohen pranë Fondit të Institutit të Arkeologjisë, në Parkun Arkeologjik të Apolonisë.
4. Miratohet në parim projekti i spostimit të parkingut të parashikuar në hyrje të Parkut të Apolonisë, sipas variantit të propozuar nga shoqëria "AD STAR" sh.p.k. Ky projekt të kalojë për miratim në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve dhe vetëm pas miratimit nga ky Këshill të vijojnë punimet e zbatimit të projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO